

ÇFARË ËSHTË IBAN-I

IBAN, numri ndërkombëtar i llogarisë bankare, është numri që banka i përcakton çdo llogarie bankare të klientëve të saj, në përputhje me Standardin Ndërkombëtar ISO 13616 “Shërbimet Bankare dhe të ngjashme–Numri Ndërkombëtar i Llogarisë Bankare–IBAN”.

ÇFARË ËSHTË IBAN-I NË SHQIPËRI

IBAN-i shqiptar është struktura e numrit ndërkombëtar të llogarisë bankare e përdorur në Republikën e Shqipërisë, e cila identifikon në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar llogarinë e një klienti pranë një banke/ dege të bankës së huaj, të licencuar nga Banka e Shqipërisë.

Struktura e IBAN-it në Shqipëri është përcaktuar në rregulloren “Për strukturën dhe përdorimin e Numrit Ndërkombëtar të Llogarisë Bankare (IBAN)”, miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 42 datë 16 korrik 2008, dhe nënkupton një sekuençë prej 28 karakteresh alfanumerike.

Duke filluar nga 1 qershor 2009, të gjithë numrat e llogarive bankare të klientëve, që përdoren për të kryer transfertat, në monedhën vendase ose në valutë të huaj, nëpërmjet sistemeve të pagesave apo bankave korrespondente, do të kenë formatin IBAN.

CILI ËSHTË QËLLIMI I PËRDORIMIT TË IBAN-IT NË SHQIPËRI

Qëllimi i IBAN është të lehtësojë procesimin automatik të transfertave. Përdorimi i IBAN-it synon rritjen e saktësisë së të dhënave të një transaksioni dhe reduktimin e ndërhyrjeve manuale në procesimin e tyre. IBAN përmirëson cilësinë, eficiencën dhe kohën e shlyerjes së transfertave kombëtare dhe ndërkombëtare, duke siguruar një shkallë sigurie më të lartë.

Me marrjen e urdhërit për kryerjen e një transferte brenda vendit apo drejt një shteti tjetër ku zbatohet standardi i IBAN-it, çdo bankë, përpara kryerjes së transfertës, kontrollon saktësinë e numrit të llogarisë bankare të përfituesit dhe urdhëruesit, nëpërmjet validimit të shifrave të kontrollit. Rreziku i vonës apo i moskryerjes së pagesës për shkak të pasaktësive, reduktohet, pasi llogaria bankare e përfituesit të fondeve, kreditohet vetëm nëpërmjet përdorimit të IBAN.

Kujdes! Vetëm banka, ku klienti ka llogarinë e tij, mund t’i sigurojë këtij të fundit IBAN-in e saktë të llogarisë, si dhe kodin BIC të bankës. Nëse ju do të kryeni një transfertë në favor të një përfituesi, nevojitet të kontaktoni përfituesin e transfertës, njëkohësisht titullar i llogarisë ku do të kalojnë fondet, për të siguruar IBAN-in e llogarisë së tij.

DIAGRAMA E IBAN-IT NË LËVIZJEN E PAGESËS

1. Banka e klientit përfitues, i siguron këtij të fundit IBAN-in e llogarisë së tij dhe kodin BIC të bankës.
2. Përfituesi i vë në dispozicion IBAN-in dhe BIC-un e bankës, urdhëruesit të transfertës.
3. Klienti urdhërues, paraqet pranë bankës së tij, instruksionet për transfertën e kreditimit në favor të përfituesit, ku përfshihen, përveç instruksioneve të pagesës, edhe IBAN-i i përfituesit si dhe kodi BIC i bankës së tij.
4. Banka e klientit urdhërues kontrollon saktësinë e IBAN-it dhe kodit BIC dhe dërgon transfertën e kreditimit pranë bankës së përfituesit. Me marrjen e urdhërpagesës, menjëherë kreditohet llogaria e përfituesit.

CILA ËSHTË STRUKTURA E IBAN-IT NË SHQIPËRI

IBAN-i në Republikën e Shqipërisë, përbëhet prej 28 karakteresh, që përfaqësojnë elementet e mëposhtme:

- a) kodin e Republikës së Shqipërisë, “AL”;
- b) shifrën e kontrollit të IBAN-it, 2 numra referuar standardit ndërkombëtar ISO 7064 “Teknologjia

e informacionit – teknikat e sigurisë – sistemet e shifrave të kontrollit”;

c) numrin bazë të llogarisë bankare (BBAN), të përbërë nga 24 karaktere alfanumerike që përfshin elementet e mëposhtme:

- kodin e identifikimit bankar (KIB) – të përbërë nga 8 karaktere numerike, që përcaktojnë në mënyrë unike bankën dhe njësinë e rrjetit të saj bankar në të cilën është hapur llogaria e klientit;
- llogarinë e klientit – të përbërë nga 16 karaktere alfanumerike. Ky numër përcaktohet nga vetë bankat. Në rast se numri ekzistues i llogarisë bankare përbëhet nga më pak se 16 karaktere, plotësohet me “0” përpara.

IBAN-i përmban vetëm karaktere alfanumerike nga A në Z (shkronja të mëdha të shtypit, latine) dhe nga 0 në 9 (numra arabikë).

IBAN-i paraqitet në instruksionet elektronike të pagesave pa hapësira boshe ose simbole ndarëse mes karaktereve alfanumerike.

IBAN-i paraqitet në dokumentet e pagesave në format letër sipas grupimeve prej katër karakteresh, të ndara me nga një hapësirë boshe.

Shembull:
IBAN
në Shqipëri

AL 47

Kodi i shtetit – për Shqipërinë kodi është “AL”.

2 shifrat e kontrollit, sipas modulit 97-10.

212 1100 9 0000000235698741

Kodi KIB:
- 3 karaktere identifikuese të bankës;
- 4 karaktere identifikuese të degës/agjencisë;
- 1 shifër kontrolli për 7 karakteret e KIB.

16 karaktere të vendosura nga vetë banka, në mënyrë unike përcaktojnë llogarinë e klientit pranë asaj banke.

BBAN

ÇFARË DUHET TË BËJNË BANKAT

Bankat duhet të krijojnë IBAN-in për çdo klient (persona fizikë dhe juridikë), brenda datës 1 qershor 2009. IBAN-i përcaktohet vetëm nga banka e klientit.

Bankat duhet të njoftojnë klientët e tyre, me shkrim, në lidhje me IBAN-in dhe kodin BIC, brenda datës 1 qershor 2009.

Numrat e llogarive sipas formatit IBAN do të aktivizohen duke filluar nga data 1 qershor 2009.

Sistemet e brendshme të bankave si dhe sistemet kombëtare të pagesave duhet të jenë në gjendje të procesojnë dhe të kontrollojnë saktësinë e IBAN-it në instruksionet e pagesave, jo më vonë se data 1 janar 2010. Deri në këtë datë, bankat mund të pranojnë instruksione pagesash, ku numrat e llogarive specifikohen sipas formatit IBAN ose sipas strukturave ekzistuese të llogarive.

ÇFARË DUHET TË BËJNË KLIENTËT

Lutemi kontaktoni pranë bankës tuaj, për t'u informuar në lidhje me IBAN-in e llogarisë tuaj si dhe kodin BIC të bankës, jo më vonë se data 1 qershor 2009.

Ju duhet të njoftoni të gjithë korrespondentët/klientët tuaj, nga të cilët ju prisni të arkëtoni transfertat në të ardhmen, në lidhje me numrin tuaj të llogarisë - IBAN, si dhe kodin BIC të bankës, brenda periudhës 1 qershor 2009 - 31 dhjetor 2009. Kërkojini korrespondentëve/furnitorëve tuaj, të cilëve ju duhet t'i dërgoni transfertat në të ardhmen, numrin e llogarisë së tyre -IBAN, si dhe kodin BIC të bankës, brenda periudhës 1 qershor 2009 - 31 dhjetor 2009.

Duke filluar nga data 1 janar 2010, IBAN do të jetë i vetmi standard i numrit të llogarisë së një klienti. Pas kësaj date, ju mund të tërhiqni fonde apo të dërgoni transfertat nga llogaria juaj, vetëm duke përdorur numrin IBAN të llogarisë.

SHEMBULL I IBAN-IT PËR SHQIPËRINË

| | |
|--------------------------|------------------------------------|
| IBAN-i format elektronik | AL47212110090000000235698741 |
| IBAN-i format letër | AL47 2121 1009 0000 0002 3569 8741 |

SHEMBUJ TË IBAN-IT NË SHTETE TË NDRYSHME

| Shteti | Nr. karaktereve | IBAN në format letër |
|----------|-----------------|------------------------------------|
| Austri | 20 an | AT61 1904 3002 3457 3201 |
| Belgjikë | 16 an | BE68 5390 0754 7034 |
| France | 27 an | FR14 2004 1010 0505 0001 3M02 606 |
| Greqi | 27 an | GR16 0110 1250 0000 0001 2300 695 |
| Itali | 27 an | IT60 X054 2811 1010 0000 0123 456 |
| Poloni | 28 an | PL27 1140 2004 0000 3002 0135 5387 |
| Slloveni | 19 an | SI56 1910 0000 0123 438 |
| Angli | 22 an | GB29 NWBK 6016 1331 9268 19 |

KUR DO TË PËRDORET IBAN NË SHQIPËRI

Duke filluar nga data 1 qershor 2009, të gjitha llogaritë e klientëve duhet të jenë në formatin IBAN.

Duke filluar nga data 1 janar 2010, IBAN do të jetë i vetmi numër i vlefshëm i llogarisë për të ekzekutuar një transfertë.

BANKA E SHQIPËRISË

Numri
Ndërkombëtar i
Llogarisë Bankare

International Bank Account Number

IBAN

www.bankofalbania.org

Banka e Shqipërisë, Sheshi
"Skënderbej" Nr.1 Tiranë, Shqipëri

Tel.: +355-(0)4-2222152;
Faks: +355-(0)4-2223558